



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 078/8
Prishtinë, më 9 korrik 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 9 DHE 10 KORRIK 2009**

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, kurse i ndihmoi anëtari i Kryesisë së Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Fjalimi vjetor i Presidentit të Republikës së Kosovës,
2. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.

02/L-36 për duhanin,

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër korrupsionit,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë,
10. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave,
11. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar,
12. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës,
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët,
14. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës,
15. Shqyrtimi i Prozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina,
16. Shqyrtimi i dokumentit- Letra e Bardhë- sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë,
17. Njoftim i Grupit Parlamentar SLS lidhur me zëvendësimin e dy anëtarëve të komisioneve parlamentare.

1. Fjalimi vjetor i Presidentit të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi Presidentin e Republikës së Kosovës, ta marrë fjalën.

Presidenti **Fatmir Sejdiu** përshëndeti deputetët e Kuvendit, Kabinetin qeveritar, përfaqësuesit e ambasadave të huaja të akredituar, si dhe të tjerët që përcillnin punimet e seancës plenare.

Në vazhdim Presidenti Sejdiu tha se do ta njoftojë Kuvendin për angazhimet e tij gjatë këtij viti, të cilin, ai e cilësoi vit të mbarë të dëshmimit, vit të funksionimit të suksesshëm dhe të rritës së përgjithshme të Republikës të pavarur dhe demokratike.

Institucionet e vendit, në të gjitha nivelet, janë forcuar, është shtuar përgjegjësia, është dinamizuar jeta dhe debati demokratik dhe për këtë merita kanë të gjithë, edhe ata që aktualisht janë bartës së qeverisjes, edhe ata që janë në opozitë, por që kanë ndikuar drejtpërdrejt në shtimin e përgjegjësisë së qeverisjes.

Jemi në vitin e dytë të shtetësisë së Kosovës dhe tanimë kemi pranuar 61 njohje nga vende të ndryshme anekënd globit. Institucionet përkatëse të vendit, Presidenti, Qeveria, përkatësisht Ministria e Punëve të Jashtme, kanë punuar me përkushtim për të arritur sa më shumë njohje.

Me qëllim të sigurimit të sa më shumë njohjeve dhe të afirmimit të vendit tonë në botë, gjatë kësaj periudhe, në mes paraqitjeve të mia vjetore para jush, unë kam realizuar takime të shumta me përfaqësues të vendeve nga të gjitha kontinentet.

Si rezultat i gjithë këtyre angazhimeve kemi realizuar takime dhe vizita tepër të rëndësishme, ndër të cilat, duhet të veçohet vizita në SHBA dhe takimi historik me Presidentin Bush në

Shtëpinë e Bardhë, më 21 gusht 2008, bashkë me përfaqësuesit e tjerë të Republikës. Këtij takimi i paraprinë takimet me sekretaren e Shtetit, Condoleezza Rice dhe me sekretarin e Mbrojtjes, z. Robert Gatës.

Përveç marrëdhënieve intensive me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ne kemi vazhduar të mbajmë raporte të ngushta me të gjitha vendet e tjera mbështetëse të Kosovës. Jemi pritur në Londër, nga Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, z. Gordon Braun, dhe nga ministri i Jashtëm, Miliband, si dhe kemi mbajtur kontakte të përhershme me përfaqësuesit kryesorë të diplomacisë evropiane, në rend të parë, me krye diplomatit e Bashkimit Evropian, zotëri Javier Solana, por edhe me funksionarë të tjerë të rëndësishëm, si Presidentin e Komisionit Evropian, Hose Manuel Barroso, Komisionarin Evropian për Zgjerim, Oli Ren e shumë të tjerë.

Si President i vendit, gjatë gjithë kësaj kohe kam mbajtur korrespondencë të rregullt me homologët e mi nga të gjitha anët e globit. Më 23 dhe 24 qershor 2009 kam marrë pjesë edhe në Samitin e Presidentëve të Rajonit, të mbajtur në Vlorë. Përveç me mikpritësin, Presidentin Topi, atje jam takuar edhe me Presidentin e Malit të Zi, Vujanović dhe me Presidentin e Maqedonisë, Ivanov.

Më 29 qershor 2009, unë dhe Kryeministri Thaçi, nënshkruam në Uashington dokumentet e pranimit së Republikës së Kosovës në institucionet më të rëndësishme financiare ndërkombëtare- në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore.

Në agjendën time të këtij viti vend me peshë i takon edhe pjesëmarrjes në Konferencën e Sigurisë në Mynih të Gjermanisë, në shkurt 2009, në të cilën ishin të pranishëm mbi 300 pjesëmarrës nga e gjithë bota, presidentë, kryeministra dhe udhëheqës të lartë shtetërorë të vendeve më të fuqishme të botës. Ky ishte rasti i parë i përfaqësimit të Kosovës në këtë mekanizëm dhe do të jetë praktikë e vazhdueshme edhe për të gjitha takimet pasuese të këtij niveli.

Gjithashtu, dua të potencoj edhe pjesëmarrjen në Forumin Ekonomik të Euro-Azisë në Stamboll, të mbajtur në maj të këtij viti, në të cilin ishin të pranishëm presidentë dhe ish-presidentë, ministra dhe ekspertë nga 41 vende Euro-Aziatike.

Siç e dini, vendi ynë do të hyjë sivjet në ciklin normal të zgjedhjeve. Duke u mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës unë kam zhvilluar një varg takimesh me drejtuesit e partive politike për të caktuar datën e mbajtjes së zgjedhjeve lokale. Pas konsultimeve të bëra, kam marrë vendim që këto zgjedhje të mbahen më 15 nëntor të këtij viti.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës siguron ndarjen e qartë të tri pushteteve themelore: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Republika e Kosovës ka themeluar edhe shtyllën më të rëndësishme kushtetuese - Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Si President i një vendi që ka nevojë për reforma rrënjësore në gjyqësor dhe prokurori, do të luaj rolin që më takon për t'i mundësuar bazat e kësaj reforme, në mënyrë që të krijohet një gjyqësor dhe prokurori tërësisht e pavarur.

Insistoj përherë që radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës të plotësohen

me njerëz të rinj, profesionistë, të dijshtëm e të përkushtuar, jashtë ndikimeve e preferencave të tjera formale dhe joformale, personalitete me respekt për të drejtën, të paanshëm dhe, para së gjithash, të pa përfshirë në veprime apo afëra korruptive.

Dua të veçoj me këtë rast se kemi punuar përherë që të jemi pjesë e dinamikës së ndërtimit të ligjeve dhe institucioneve të reja. Që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kam dekretuar mbi 90 ligje të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Duke pasur parasysh faktin se avancimi ekonomik i vendit zë një vend parësor në politikat tona shtetërore, kam shpallur ligje nga fusha e ekonomisë që shpresojmë se do ta drejtojnë Republikën e Kosovës drejt një zhvillimi substancial ekonomik.

Më 15 qershor 2009, kam dekretuar emërimin e eprorëve të lartë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Besoj se ky akt do të ketë efektet e dëshiruara në qëllimin tonë të përbashkët për të pasur një forcë moderne dhe të disiplinuar.

Në kuadër të avancimit të pozitës së komuniteteve në Republikën e Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së zotimeve tona për Planin Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari, unë kam themeluar Këshillin Konsultativ për Komunitete që funksionon si pjesë e Zyrës së Presidentit. Kam kënaqësinë e veçantë t'ju informoj se ky këshill tanimë ka kryesuesin e vet dhe zëvendësit e tij dhe është tërësisht funksional që t'i përmbushë detyrat e shtruara.

Anëtarësimi i Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore është një arritur e jashtëzakonshme, që duhet të shfrytëzohet për t'i dhënë impulse të reja përparimit ekonomik të vendit.

Në mes dy paraqitjeve të mia vjetore para jush, unë kam zhvilluar shumë takime me qytetarët e vendit. Vlerësoj se institucionet e Kosovës mund të bëjnë më tepër për të mirën e qytetarëve duke hapur perspektivën e zhvillimit ekonomik dhe duke shtuar shkallën e përkujdesjes sociale.

Më 17 shkurt dhe më 8 gusht 2008, në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës, unë i kam bërë ftesë Bashkimit Evropian që ta dërgojë në vendin tonë Misionin Civil Ndërkombëtar, të udhëhequr pikërisht nga Bashkimi Evropian dhe me prezencën e Shteteve të Bashkuara. Në bazë të kësaj kërkesë, EULEX-i tashmë është në Kosovë dhe pavarësisht disa vonesave, që nga fillimi i shtrirjes së tij në terren, ka shënuar disa rezultate të rëndësishme.

Po ashtu, ritheksoj kërkesën tonë për rikonfigurimin e UNMIK-ut, me qëllim të përmbjlljes së këtij misioni, i cili, përkundër vonesave, mund të quhet një storie e suksesshme e angazhimit ndërkombëtar në Kosovë.

Një falënderim të veçantë kemi për komandantët dhe ushtarët e KFOR-it, të cilët si me punën e tyre profesionale për ruajtjen e Kosovës, ashtu edhe me angazhimet e tjera në fushën civile, siç janë ndërtimi i rrugëve dhe i urave, ndërtimi i shkollave dhe i objekteve të tjera për qytetarët e vendit tonë, janë pa dyshim shembull më vete i suksesit në Kosovë.

Institucionet e Republikës së Kosovës, Kuvendi, Qeveria, pushteti lokal dhe të gjitha hallkat e

shtetit tonë, duhet dhe do të vazhdojnë të punojnë me përkushtimin më të madh për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe për thellimin e stabilitetit e të sigurisë për të gjithë.

Përfundimisht, integrimi i Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në mekanizmat e tjerë ndërkombëtar, si dhe forcimi i bashkëpunimit dhe i miqësisë speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është motoja kryesore e angazhimeve tona. Ky përcaktim shpreh vullnetin politik të popullit të Kosovës, të institucioneve dhe subjekteve të saj politike dhe prej tij nuk heqim dorë për asnjë çmim.

Fjalimi i plotë i Presidentit Sejdiu është dhënë në transkript.

2. Miratimi i Procesverbalit të seancave plenare, të mbajtura më 12 dhe 23 qershor 2009

Kuvendi miratoi pa vërejtje Procesverbalin e seancave plenare, të mbajtura më 12 dhe 23 qershor 2009.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Gjylnaze Syla parashtroi pyetje për Kryeministrin, Hashim Thaçi lidhur me veprimet e Qeverisë për kthimin e pasurisë arkeologjike dhe etnologjike të Kosovës, e cila gjendet në Serbi.

Në mungesë të Kryeministrit, pyetjes së deputetes Syla, iu përgjigj ministri Ahmet Shala.

Deputeti Driton Tali parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë e Financave, Ahmet Shala, lidhur me iniciativën për krijimin e Postë-Bankës.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti Driton Tali parashtroi pyetje për ministren e Energjetikës dhe Minierave, Justina Shiroka -Pula, lidhur me privatizimin e Distribucionit në KEK.

Ministrja Justina Shiroka -Pula iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti Driton Tali parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë e Financave, Ahmet Shala, lidhur me veprimet e Ministrisë për objektin e PTK-së, në lokacionin e ashtuquajtur “Qafa” në Prishtinë.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja Nerxhivane Dauti parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë e Financave, Ahmet Shala, lidhur me shkaqet e vonesës së procedimit të Projektligjit për masat doganore për mallrat që cenojnë të drejtat e autorit dhe markat tregtare, në Kuvendin e Kosovës.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputeti Naser Rugova parashtroi pyetje për ministren e Energjetikës dhe Minierave, Justina Shiroka -Pula, lidhur me strategjinë e Qeverisë së Kosovës për të ardhmen e Kombinatit “Trepça”.

Ministrja Justina Shiroka -Pula iu përgjigj pyetjes së deputetit Rugova.

Deputeti Riza Smaka parashtroi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me përfilljen e dispozitës ligjore për Deklaratën e ushqimit, për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve.

Ministri Gashi iu përgjigj pyetjes e së deputetit Smaka.

Të drejtën për të lexuar pyetjet në seancë e shfrytëzuan deputetët: Fatmire Berisha, Naser Rugova, Drita Maliqi (4 pyetje), Emrush Xhemajli dhe Riza Smaka.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin e lartpërmendur.

Ministrja Nekibe Kelmendi, tha se dekoratat ashtu siç parasheh ky projektligj u jepen individëve, institucioneve, qytetarëve të vendit, qytetarëve të huaj dhe personave juridikë që shquhen për merita të veçanta. Baza juridike për hartimin e këtij projektligji buron nga neni 84, pika 28 e Kushtetutës së Kosovës.

Në vazhdim tha se Projektligji do të jetë pjesë e legjislacionit të ri dhe është hera e parë që një projektligj i tillë procedohet në Kuvend, edhe pse deri më tani ekzistonin disa akte, por që nuk kanë qenë të kodifikuara në një projektligj, çfarë është ky për të cilin po flasim. Ajo më tej tha se Projektligji ka 4 kapituj me 37 nene dhe nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian, sepse në Bashkimin Evropian secili shtet anëtar këtë çështje e rregullon me norma ligjore të brendshme.

Në fund ministrja Kelmendi ftoi deputetët që ta miratojnë në parim projektligjin.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë. Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Kolë Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, si dhe deputetët: Sabri Hamiti, Gjylnaze Syla, Berim Ramosaj, Riza Smaka, Hydajet Hyseni, Adem Hajdari, Ethem Çeku dhe Drita Maliqi, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----44,
Kundër-----18,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues; Komisionin për Buxhet dhe Financa; Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që projektligjin t'a shqyrtojnë brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Ministri **Ahmet Shala**, tha se ky projektligj është hartuar në bashkëpunim me komunitetin e biznesit, është në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare nga kjo lëmi dhe është i harmonizuar me legjislacionin e BE-së.

Në vazhdim tha se projektligji trajton devidendën, dispozitat e ashtuquajtura të borgjit të keq, etj. Në këtë projektligj është pasqyruar edhe zgjerimi i konceptit të ashtuquajtur detyra të përjashtuara. Ministri tha se janë paraparë lirime speciale për komunitetet fetare në Kosovë. Në lidhje me dispozitat e borgjit të keq, ministri tha se, ato janë harmonizuar me rregulloret e BE-së dhe se këto rregulla janë të thjeshtëzuara në atë masë sa nuk i ngarkojnë bizneset në Kosovë. Ai vuri në pah se me fillimin e vitit 2009, norma tatimore në të ardhurat e korporatave është zvogëluar nga 20% në 10%. Ministri Shala tha se në këtë projektligj janë avancuar dispozitat administrative nga kjo lëmi. Projektligji ka 9 kapituj me 30 nene.

Në fund ai kërkoi nga deputetët miratimin në parim të këtij projektligji.

Kryetari hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Enis Kervan, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të SLS, Mursel Halili, si dhe deputetët Myzejene Selmani, Driton Tali dhe Fatmir Rexhepi, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbal.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----54,
Kundër-----3,
Abstenime-----8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim, Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues; Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi; Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që projektligjin ta shqyrtojnë brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për miniera dhe minerale.

Ministrja Justina Shiroka -Pula tha se Projektligji për miniera dhe minerale sjell një promovim të aktiviteteve minerale, zhvillim dhe modernizim e këtij sektori, në përputhje me standardet mjedisore dhe sigurinë në punë. Ajo tha se projektligji përcakton kuadrin ligjor për përshkrimin e të drejtave minerale, për hulumtimin, pasurimin dhe zhvillimin e lëmisë së minierave dhe mineraleve në përgjithësi. Ky projektligj do të zëvendësojë Rregulloren e UNMIK-ut për krijimin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, zonat me interes të veçantë etj. Më tej, ajo tha se këta sektorë do të zhvillohen në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut në drejtim të vendosjes së parametrave relevant. Ministrja tha se projektligji përmban 14 kapituj me 88 nene, është në përputhje me praktikën ndërkombëtare nga kjo lëmi dhe në përpilimin e tij kanë ndihmuar ekspertët e huaj. Në fund ajo kërkoi nga deputetët miratimin në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim në parim të Projektligjit për miniera dhe minerale

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha – Shala në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të SLS, Mursel Halili, si dhe deputetët: Kaqusha Jashari, Driton Tali, Mahir Yagcilar, Bahri Hyseni, Riza Smaka, Shkumbin Demaliaj, Armend Zemaj dhe Berim Ramosaj, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----45,
Kundër-----14,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për miniera dhe minerale.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që projektligjin ta shqyrtojnë brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-36 për duhanin

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-36 për duhanin.

Ministri Alush Gashi, tha se pas shpalljes së Ligjit për duhanin në vitin 2007, është ngritur shqetësim në lidhje me nenin 6 të atij ligji, por vërejtjet i referohen edhe udhëzimeve administrative që dalin nga ai ligj. Grupet punuese i kanë definuar këto gjëra dhe tani kërkohet nga deputetët që t'i përkrahin këto ndryshime dhe plotësime.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-36 për duhanin.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë. Në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së Nurishahe Hulaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Rita Hajzeraj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të SLS, Mursel Halili, si dhe deputetët: Emrush Xhemajli, Armend Zemaj, Alush Gashi, Naser Rugova, Flora Brovina, Ibrahim Makolli, Riza Smaka, Fatmir Rexhepi dhe Ardian Gjini, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----7,
Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-36 për duhanin.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që projektligjin ta shqyrtojnë brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit kundër korrupsionit

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin kundër korrupsionit.

Ministrja Nekibe Kelmendi tha se sipas strategjisë legjislative shtrohet kërkesa për ndryshimin e ligjit në fuqi, me qëllim që të eliminohen zbrastësitë dhe mangësitë. Ajo tha se qëllim tjetër është marrja e masave kundër korrupsionit, përcaktimi i qartë i rolit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Në vazhdim tha se ky projektligj dhe ai për parandalimin e konfliktit të interesit, përbëjnë një pako të mirë në luftimin sa më efikas të korrupsionit. Me këtë projektligj parashihet themelimi i Komisionit parlamentar, i cili do të drejtohet nga opozita.

Ajo tha se projektligji rregullon edhe çështjen e pranimit të dhuratave nga zyrtarët e lartë shtetëror, gjë që është sugjeruar nga zyrtarë të Komisionit Evropian. Ky projektligj rregullon edhe ruajtjen e të dhënave, shënimeve dhe fshehtësinë e informatave si dhe është në përputhje me Konventën Evropiane Antikorrupsion, tha ministrja Kelmendi. Në fund ajo ftoi deputetët që ta përkrahin miratimin në parim, të këtij projektligji.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 37 deputetë dhe e deklaroi të ndërprerë për sot seancën plenare, për të vazhduar me punimet e seancës ditën e nesërme, e premte më 10 korrik 2009, në ora 10:00.

Seanca mbylli punimet në orën 18:03 minuta.

E premte, 10 korrik 2009, në orën 10:00 **Vazhdimi i seancës plenare**

Seancën plenare e drejtoi Jakup Krasniqi, kurse i ndihmoi anëtari i Kryesisë, Xhavit Haliti.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 79 deputetë.

Kryetari i njoftoi deputetët se debati për Projektligjin kundër korrupsionit është ndërprerë për shkak se nuk kishte kuorum, andaj ai shtoi se po vazhdohet me shqyrtimin e këtij projektligji.

Ai hapi debatin për shqyrtim në parim të Projektligjit kundër korrupsionit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë. Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Kervan, si dhe deputetët: Ardian Gjini, Sanije Aliaj, Suzan Novobërdaliu, Gjylnaze Syla, Hydajet Hyseni, Njomza Emini, Myrvete Pantina, Vezira Emrush, Gani Koci, Zafir Berisha, Riza Smaka, Naser Rugova, Mark Krasniqi dhe Ibrahim Makolli, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----54,
Kundër-----11,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin kundër korrupsionit.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që

projektligjin ta shqyrtojnë brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë

Ministri Ahmet Shala, tha se pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, jemi ballafaquar me çështjet e prokurimit, sidomos me rregullat për blerjen e objekteve të ambasadave të Republikës së Kosovës në shtetet e huaja, furnizimin e tyre, qiranë dhe pagesa të tjera.

Gjithashtu tha se Grupi punues ka hartuar një projektligj të ri i cili përbëhet prej 7 neneve gjithnjë duke marr parasysh specifikat e shteteve.

Në fund ministri ftoi deputetët që ta përkrahin miratimin në parim të këtij projektligji.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Kosara Nikoliç, si dhe deputetët: Vlora Çitaku, Sabri Hamiti, Bahri Hyseni dhe Myzejene Selmani, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----55,
Kundër-----2,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë.

Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian. Komisionet e lartpërmendura duhet që projektligjin ta shqyrtojnë brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave

Kryesuesi ftoi Kryetaren e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ose raportuesin e Komisionit, që ta marrë fjalën.

Myzejene Selmani tha se Komisioni e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe kemi konstatuar se ka implikime të mëdha buxhetore, si pasojë e të cilave ligji nuk mund të zbatohet.

Ajo tha se, përpos kësaj ky projektligj ka edhe mangësi përmbajtjesore dhe juridike dhe për këtë duhet të pësojë ndryshime të mëdha.

Në fund, tha ajo i rekomandojmë Kuvendit që Projektligji për rezervat shtetërore të mallrave, t'i kthehet sponsoruesit me kërkesë që ai të rihartohet në përputhje me standardet themelore të legjislacionit.

Pasi nga deputetë e tjerë nuk pati të paraqitur për fjalë, Kryesuesi e hodhi në votim Rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----31,
Kundër-----4,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Projektligji për rezervat shtetërore të mallrave i kthehet sponsoruesit Qeverisë së Kosovës, sipas rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

11. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi ose raportuesin e Komisionit, që ta marrë fjalën.

Bahri Hyseni tha se në Komision funksional kemi bërë amendamentimin e këtij projektligji dhe kërkoi nga deputetët që t'i miratojnë këto amendamente.

Pasi as nga Komisioni funksional, e as nga deputetët tjerë nuk pati të paraqitur për ta marrë fjalën, kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Zhvillim Rural, dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,
Kundër-----3,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar.

12. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ose raportuesin e Komisionit, që ta marrë fjalën.

Sadik Idriz tha se ne si Komision funksional kemi përfunduar punën në lidhje me këtë projektligj dhe Kuvendit i kemi paraqitur amendamentet e propozuara.

Pasi nga deputetët tjerë nuk pati të paraqitur për ta marrë fjalën, Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----53,
Kundër-----5,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët

Kryesuesi ftoi kryetaren e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ose raportuesin e Komisionit që ta marrë fjalën.

Myzejene Selmani tha se detyrë e Komisionit që ajo drejton është që të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve në fushat që ky komision i mbulon. Ne si Komision kemi bërë katër vizita në teren në tri shkallë të institucioneve: në ato lokale- komunat Prishtinë , Mitrovicë dhe Gjakovë; në institucione qendrore – Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe vizita në teren në rrugën e Dushkajës, komuna e Gjakovës. Në vazhdim ajo tha se me rastin e këtyre vizitave, Komisioni identifikoi problemet dhe mbi këtë bazë i kemi bërë rekomandimet të cilat ia kemi paraqitur Kuvendit në seancë plenare.

Ministri Fatmir Limaj tha se e përgëzoj Komisionin për punën e bërë dhe se sugjerimet dhe rekomandimet e Komisionit do t'i marrim parasysh.

Ai tha se Ministria të cilën e drejton e ka aktivizuar Inspektoratin Rrugor, ku në vitin 2008 janë bërë 243 inspektime. Po ashtu, tha ministri, jemi përpjekur për definimin sa më të mirë të brezit rrugor. Në vazhdim tha se ndërtimet përgjatë brezit rrugor, sipas ligjit janë të ndaluara, pa pëlqimin e MTPT-së. Edhe Komunat nuk kanë të drejtë të lëshojnë leje ndërtimi gjatë brezit rrugor, pa pëlqimin e MTPT-së, tha ministri.

Kryesuesi hapi debat për Shqyrtimin e raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë këta deputetë. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Haset Cakolli, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, si dhe deputetët: Adem Grabovci, Armend Zemaj, Kaqusha Jashari, Gjylnaze Sylja, Sala Berisha-Shala, Riza Smaka, Ibrahim Makolli, Gani Buçinca, Fatmir Limaj dhe Myzejene Selmani që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryesuesi hodhi në votim Raportin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----54,
Kundër-----14,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi raportin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët.

14. Shqyrtimi i Raportit të Komisioni Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, që ta marrë fjalën.

Hydajet Hyseni tha se Komisioni Parlamentar ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës ka bërë intervistimin e një numri mjaft të madh të kandidatëve të paraqitur. Komisioni pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes, në pajtim me Rregullën 2008/12 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës i rekomandon Kuvendit që si kandidatë të mundshëm për pozitën - Anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, këta kandidatë:

1. Sabile Avdylin dhe
2. Ali Dragushën.

Kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare që të caktojnë nga një anëtar për Komisionin votues. Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

Gani Kocin, nga PDK-ja, kryetar i Komisionit votues
Armend Zemaj, nga LDK-ja, anëtar
Ibrahim Selmanaj, nga AAK-ja, anëtar
Suzan Novobrdaliu, nga AKR-ja, anëtar
Naser Rugova, nga LDD-ja, anëtar
Enis Kervan, nga Grupi “7+”, anëtar dhe
Dragan Dimiq, nga SLS, anëtar.

Pas procedurës së votimit kryetari i Komisionit votues, Gani Koci i deklaroi rezultatet e votimit si në vijim:

1. Në votim kanë marrë pjesë gjithsejt 74 deputetë,

2. Për kandidaten Sabile Avdyli kanë votuar 39 deputetë,
3. Për kandidatin Ali Dragusha kanë votuar 25 deputetë,
4. Dhjetë (10) fletëvotime kanë qenë të pavlefshme.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori vendim që Sabile Avdyli të emërohet anëtare e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

15. Shqyrtimi i Prozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina

Kryesuesi ftoi Kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor ose raportuesin e Komisionit, që ta marrë fjalën.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka asnjë deputet të paraqitur për fjalë, as nga komisionet dhe as nga grupet parlamentare.

Kryesuesi hodhi në votim Prozimvendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----26,
Kundër-----31,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk miratoi Propozim- vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina.

16. Shqyrtimi i dokumentit- Letra e Bardhë- sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ose raportuesin e Komisionit, që ta marrë fjalën.

Naser Rugova tha se flet në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe të Grupit Parlamentar të LDD-së. Ai tha se dokumenti Letra e Bardhë ka për qëllim intensifikimin e angazhimeve të Kuvendit lidhur me çështjet e mirëqenies sociale.

Në vazhdim tha se Letra e Bardhë është dokument i lëshuar nga institucionet shtetërore, por si e tillë nuk ka karakter obligativ dhe as implikime buxhetore. Në përpilimin e këtij dokumenti ka ndihmuar UNDP-ja. Përfshirja sociale është një koncept që mundëson që të gjitha grupet të luajnë një rol në çështjet sociale, punësimin etj. si dhe të dëgjohet zëri i tyre në procesin e vendimmarrjes. Në fund, ai përkujtoi se Kuvendi ka aprovuar edhe Deklaratën e Mijëvjeçarit si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë dokument.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë dokument dhanë këta deputetë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Mimoza Ahmeti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nurishahe Hula, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Rita Hajzeraj, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar të “7+”, Xhezair

Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Slobodan Petroviq, si dhe deputetët: Gjylnaze Sylaj, Xhevdet Neziraj, Emrush Xhemajli, Driton Tali dhe Luljeta Shehu, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi hodhi në votim dokumentin- Letra e Bardhë- sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi dokumentin Letra e Bardhë- sfidat e përfshirjes sociale në Kosovë, sipas rekomandimeve të komisioneve funksionale.

17. Njoftim i Grupit Parlamentar SLS lidhur me zëvendësimin e dy anëtarëve të komisioneve parlamentare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi parlamentar i SLS-së ka vendosur që anëtar në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi emërohet deputeti Vladimir Todoroviq, në vend të deputetit Branislav Grbiq dhe në Komisionin për Integritet Evropian, emërohet deputeti Mursel Halili, në vend të deputetit Branislav Grbiq.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi vendosi që deputeti Vladimir Todoroviq emërohet anëtar në komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, nga GP SLS, kurse deputeti Mursel Halili emërohet anëtar në Komisionin për Integritet Evropian, po ashtu nga GP SLS.

Seanca i përfundoi punimet në orën 18: 05 minuta.

**Kryetari i Kuvendit
Jakup Krasniqi**

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**